



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 1510, Datë 25/04 2015

PËR

**KRITERET DHE PROCEDURAT E ORGANIZIMIT TË TESTIMIT PËR POZICIONIN  
E NDIHMËSIT LIGJOR NË GJYKATAT ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të paragrafit 2, të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar dhe të pikës 3 të nenit 6/4 të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e kriterëve dhe procedurave të organizimit të testimit për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat administrative, sipas tekstit që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe struktura përgjegjëse për administratën e gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NASIP NAÇO



## KRITERET DHE PROCEDURAT E ORGANIZIMIT TË TESTIMIT PËR POZICIONIN E NDIHMËSIT LIGJOR NË GJYKATAT ADMINISTRATIVE

1. Kryetari i gjykatës i komunikon strukturës përgjegjëse për administratën e gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë (këtu e në vijim “*struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore*”) vendet e lira për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatë, të cilat duhet të shpallen për konkurs të hapur.
2. Struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit për vendet vakante, shpall datën e konkurrimit të hapur në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Kandidatët e interesuar për t’u emëruar ndihmës ligjorë paraqesin kërkesën pranë Ministrisë së Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së njoftimit për vendin vakant.
4. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:
  - a) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
  - b) Vlerësimi i kandidatëve.
5. Komisioni *ad hoc*, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimi të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kriteret për përjashtim nga procedura e konkurrimit si dhe kandidatët, të cilët përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, për t’iu nënshtruar procedurës së konkurrimit.
6. Plotësimi i vendeve të lira për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatë bëhet së pari nga lista e kandidatëve që përmbushin kriteret për përjashtim nga procedura e konkurrimit dhe, në rast mosplotësimi të vendit të lirë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.
7. Në përfundim të verifikimit, sipas pikës 5, kandidatët, të cilët përjashtohen nga procedura konkurrimit dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në listat përkatëse sipas rendit alfabetik.
8. Listat e përmendura në pikën 7 më sipër administrohen nga struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore, dhe shpallet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë, rubrika “Njoftime”. Lista e kandidatëve që përjashtohen nga procedura e konkurrimit, pasi nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit *ad hoc*, i përcillet kancelarit të gjykatës për vijimin e mëtejshëm të procedurës së përzgjedhjes dhe propozimit për emërim të ndihmësit ligjor.
9. Kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njoftohen nga struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore.



10. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listave, në përputhje me pikën 7, kandidati ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë strukturës përgjegjëse për administratën gjyqësore. Shqyrtimi i ankimit bëhet nga Komisioni *ad-hoc* dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

11. Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;
- b) vlerësimi me shkrim;
- c) intervista e strukturuar me gojë.

12. Totali i pikëve të vlerësimin të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, 15 pikë;
- b) për intervistën e strukturuar me gojë, 15 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, 70 pikë.

13. Komisioni *ad hoc*, 24 (njëzet e katër) orë përpara zhvillimit të fazës së vlerësimin të kandidatëve, përgatit një grup pyetjesh për testimin e fushës së njohurive, të aftësive e të cilësive të shpallura.

14. Komisioni *ad hoc*, ditën e testimit, përgatit një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët për intervistën e strukturuar me gojë. Intervista e strukturuar me gojë ka për qëllim vlerësimin e jetëshkrimit, të njohurive dhe të aftësive të kandidatëve.

15. Nëse kandidati grumbullon të paktën 40 pikë nga vlerësimi me shkrim, ai i nënshtrohet intervistës së strukturuar me gojë.

16. Komisioni *ad hoc*, në përfundim të fazës së vlerësimin të kandidatëve, liston kandidatët fitues me mbi 70 pikë (mbi 70 % të pikëve), duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë. Lista pasi nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit *ad hoc*, i përcillet gjykatës përkatëse.

17. Kandidatët me pikë të barabarta renditen sipas rendit alfabetik.

18. Nëse asnjë nga kandidatët nuk merr 70 pikë (70% të pikëve), atëherë Komisioni *ad hoc* vendos përfundimin e fazës së vlerësimin të kandidatëve pa asnjë të përzgjedhur fitues.

19. Struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore, në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues ose me më pak fitues se planifikimi, rihap procedurën e pranimin, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit të Komisionit *ad hoc*. Në këtë rast, afati i dorëzimit të dokumenteve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike.



20. Në rast se numri i kandidatëve fitues është më i madh se numri i vendeve të lira të shpallura, të dhënat për kandidatët e tjerë mbahen në një listë pritjeje, pa qenë e nevojshme kryerja e një testimi tjetër seleksionues, në rastet e krijimit të një vendi vakant. Lista e pritjes administrohet nga struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore dhe kancelari i gjykatës dhe vlen për një periudhë jo më të gjatë se 2 vjet.

21. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e Komisionit *ad hoc* në gjykatën administrative të shkallës së parë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.